

## Vendim nr. 242 datë 18.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 18.10.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 14 (K) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** **KLITON SPAHIU, PETRIT ÇENO**

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-663, datë 11.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 15, pika 2, 23, pikat 1 dhe 2, 35, pikat 2 dhe 3, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 399/2, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d” dhe 399/10 të Kodit të Procedurës Civile; neni 291 i Kodit të Procedurës Penale; vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, çështjet “*Laçi kundër Shqipërisë*” dhe “*Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë*”; nenet 27, 50, pika 4 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka regjistruar procedimin penal nr. 113, të vitit 2015, në ngarkim të kërkuësve, për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, dhe “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal (*KP*).

2. Gjithashtu, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga kërkuësi, ka regjistruar kallëzimin penal nr. 3186 të vitit 2018. Në këtë kallëzim kërkuësi kanë pretenduar se prokurorët e çështjes, të cilët i kanë ata (kërkuësi) nën hetim, kanë shpërdoruar detyrën, pasi kanë tejkaluar afatet e hetimit, i kanë konsideruar të pandehur pa u njoftuar akuzat, sipas nenit 34, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) dhe se nuk i janë vënë në dispozicion aktet e dosjes. Sipas kallëzimit të kërkuësve, të dhënat e dosjes në ngarkim të tyre janë publikuar në media, duke mos respektuar kufizimin ligjor për publikimin e akteve hetimore, sipas parashikimeve të neneve 103, pikat 1 dhe 2, si dhe 279 të *KPP*-së.

3. Në lidhje me këtë kallëzim të bërë nga kërkuësi, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Për këtë arsye, kërkuësi i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar prishjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal dhe urdhërimin e prokurorit të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3147 akti, datë 12.07.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuësve dhe urdhërimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme në drejtim të zbardhjes së faktit nëse ndodhemi përpara elementeve të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i *KP*-së, si dhe në evidentimin e personave përgjegjës që kanë lejuar publikimin e akteve të dosjes hetimore nr. 113 të vitit 2015. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2314, datë 31.10.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 3147 akti, datë 12.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e kërkesës. Sipas gjykatës së apelit, organi i akuzës ka vepruar në respekt të së drejtës dhe detyrës së saj që normohet nga Kushtetuta dhe ka vendosur mosfillimin e procedimit, objekt ankimi brenda kufijve të sipërcituar në vendim, pasi ka konstatuar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Kundër këtij vendimi kanë bërë rekurs kërkuessit.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-663, datë 11.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk është bërë për asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është i argumentuar mjaftueshëm, në përputhje me ligjin procedural penal, duke u kthyer përgjigje pretendimeve të kërkuessve, disa prej të cilave janë të përsëritura në mënyrë të njëjtë në rekurs.

7. Në datën 12.09.2024 kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili dhe është regjistruar në të njëjtën datë.

## II

### Pretendimet e kërkuessve

8. **Kërkuessit**, në mënyrë të përmblodhur, kanë pretenduar se u është cenuar:

8.1. *E drejta e aksesit substancial e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim në drejtim të zbatimit të ligjit procedural penal, si edhe në drejtim të bazueshmërisë në themel të shkaqeve të rekursit, të cilat lidheshin me aspekte kushtetuese të procesit. Në këtë mënyrë, Kolegji Penal nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs. Gjithashtu, afati 15-ditor, i parashikuar në nenin 291 të KPP-së, është thelbësor dhe prekluziv për ecurinë e mëtejshme të procedimit penal, dhe nuk është në vullnetin e prokurorit të çështjes që të vlerësojë se kur ai duhet të marrë një vendim për mosfillimin e tij.

8.2. *E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshem*, pasi kallëzimi penal është regjistruar në vitin 2018 dhe procesi gjyqësor për kundërshtimin e vendimit të organit të akuzës për mosfillimin e procedimit penal ka përfunduar në vitin 2024. Për këtë arsye, Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mund të caktojë një dëmshpërblim për shpenzimet gjyqësore të kryera nga kërkuessit.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimimin e kërkesëve

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Në këtë këndvështrim, kërkesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi janë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

11. Në lidhje me përmbushjen e kriterit tjetër për legjitimimin, që lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 15, datë 07.05.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, për sa i përket pretendimit të kërkesëve për konstatimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh, pas hyrjes në fuqi të instrumentit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit, sipas neneve 399/1 - 399/12 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në

përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 3, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji konstaton se këtë pretendim kërkuesit e kanë parashtruar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Ata nuk rezultojnë të kenë bërë asnjë përpjekje dhe nuk kanë përdorur asnjë nga instrumentet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për të kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave (*neni 399/5 i KPC-së*). Për rrjedhojë, për këtë pretendim ata nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

14. Ndërkohë, ata e përmbushin kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive për pretendimet e tjera të paraqitura në ankimin kushtetues individual, pasi ato kanë të bëjnë me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk kanë mjete të tjera ankimi për të shteruar për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

15. Kërkuesit legjitimohen *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 11.04.2024, i cili sipas informacionit të sjellë nga Gjykata e Lartë është bërë i disponueshëm për palët në datën 22.07.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 12.09.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi, sipas tyre, Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim në drejtëm të zbatimit të ligjit procedural penal, si edhe në drejtëm të bazueshmërisë në themel të shkaqeve të rekursit, të cilat lidheshin me aspekte kushtetuese të procesit dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs. Po kështu, kërkuesit kanë ngritur pretendime edhe për interpretimin dhe zbatimin e nenit 291 të KPP-së, duke pretenduar se afati i parashikuar në këtë dispozitë është thelbësor dhe prekluziv për ecurinë e mëtejshme të procedimit penal dhe se nuk është në vullnetin e prokurorit që të vlerësojë se kur duhet të marrë një vendim për mosfillimin e tij.

17. Gjykata ka ritheksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e zbatimit të ligjit material është, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme dhe se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih*

vendimet nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Për rrjedhojë, për sa i përket pretendimit të kërkuarve që lidhet me nenin 291 të KPP-së, Kolegji, bazuar në natyrën e tij dhe përmbajtjen e argumenteve, mbi të cilat është mbështetur ky pretendim, vlerëson se, në thelb, ai ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit të zbatueshëm, për rrjedhojë, për nga natyra e tij, nuk hyn në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

18. Për sa i përket procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, Kolegji vëren se ajo është vënë në lëvizje në bazë të rekursit të paraqitur nga kërkuarët, të cilët kanë pasur mundësinë të parashtrajnë të gjitha pretendimet e tyre në lidhje me procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e apelit dhe vendimmarrjen e asaj gjykate. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me funksionin dhe kompetencat e tij, pasi ka marrë në shqyrtim dhe ka analizuar shkaqet e rekursit, ka vlerësuar se nuk bëjnë pjesë në ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, për rrjedhojë ka vendosur mospranimin e tij. Kolegji vlerëson se vetëm fakti se Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit, nuk është i mjaftueshëm, në aspektin kushtetues, për të vënë në dyshim procesin gjyqësor të zhvilluar atë gjykatë në drejtim të respektimit të së drejtës së aksesit. Nga ana tjetër, edhe arsyetimi i kufizuar i vendimit të asaj gjykate nuk cenon procesin e rregullt ligjor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mosprimit të rekursit nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit.

19. Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkuarët nuk kanë arritur të argumentojnë, në aspektin kushtetues, pretendimet e tyre për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, ata nuk legjitimohen *ratione materiae* për pretendimet e tyre të paraqitura në ankimin kushtetues individual.

20. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuarët nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a”, “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.